

VENDIM
Nr.735, datë 1.7.2009

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT
RRUGOR "UNAZA VERIORE, KORÇË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, date 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", dhe të nenit 8 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private (tokë truall), që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Unaza veriore, Korçë".
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 581 (pesëqind e tetëdhjetë e një) m², tokë truall, me vlerë të përgjithshme shpronësimi 10 655 540 (dhjetë milionë e gjashtëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e dyzet) lekë.
 4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 221 000 (dyqind e njëzet e një mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.
 5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, 10 655 540 (dhjetë milionë e gjashtëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e dyzet) lekë, të përballohet nga llogaria e veçantë e Ministrisë së Financave në Bankën e Shqipërisë "Fondi i shpronësimeve".
 6. Shpronësimi të fillojë në korrik 2009 dhe të përfundojë më 30.9.2009.
 7. Pronarët e përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi "Konfirmim ZRPP", të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
 8. Pronarët e përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi "Konfirmim ZRPP, bashkëpronësi", të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë origjinal të pronësisë, sipas bashkëpronarëve, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
 9. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të bëjë likuidimin e pronarëve, sipas listës, që i bashkëlidhet këtij vendimi, në përputhje me dokumentacionin e pronësisë, që do t'i vihet në dispozicion nga pronarët.
 10. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
 DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
 DREJTORIA JURIDIKE
 SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR "UNAZA VERIORE KORÇË"

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Z.K.	Nr. pasurisë	Lloji i pasurisë			Vlera totale (lekë)	Shënime
						Truall				
						Sip.	Çmimi	Vlera		
1	Ali		Muço	8564	3/198	127	18340	2329180	2329180	Konfir. nga ZVRPP
2	Sabri	Xhaferr	Beshiri	8564	7//94	2	18340	36680	36680	Sipas LN nga ZVRPP
3	Meleq	Alizot	Beshiri	8564	7//95	5	18340	91700	91700	Sipas LN nga ZVRPP
4	Meleq	Alizot	Beshiri	8564	7//96	10	18340	183400	183400	Sipas LN nga ZVRPP
5	Seit	Ajredin	Beshiri	8564	7//97	40	18340	733600	733600	Sipas LN nga ZVRPP
6	Familja		Qelibari	8564	7/967	290	18340	5318600	5318600	Konf. bashkëpronësi ZVRPP
7	Familja		Gjysma	8564	3/743	107	18340	1962380	01962380	Konf. bashkëpronësi ZVRPP
		Shuma				581		10655540	10655540	